

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/ Kryegjykatësi Smith tregon me detaje rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/denimi-i-4-ish-lidereve-te-uck-kryegjykatesi-smith-tregon-me-detaje-rastin-e-zhdukjes-se-behajdin-allaqit/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 12:10:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 12:06:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8bf817c70dc267e98c5a9a202b1b266bb88ce3ab050d14e39d1fa029413c3c2d
TEKSTI	7fb52aa7e8f8751ae065a4a5bd8625d2fe9966e546129560f8aebcd8eabbd6f5
PAMJA	611e59ca16186bccbe20d1c7f72ab80869550b3aeb265daab7779bd574eebbe9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d57e8d2b379e1a36248d4d41d8a3ad024118fbddb8d0c07d6666af4043f9c7c4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/d57e8d2b379e1a36248d4d41d8a3ad024118fbddb8d0c07d6666af4043f9c7c4

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/ Kryegjykatësi Smith tregon me detaje rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit

by Lajm Lajm — September 16, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Gjykata Speciale e Hagës dënoi sot me 81 vite burg të katër ish liderët e UÇK-së, Hashim Thaçin (25 vite burg), Kadri Veselin (18 vite burg), Jukup Krasniqin (25 vite burg) dhe Rexhep Selimin (13 vite burg).

Në vendimin e plotë të lexuar nga kryegjykatësi Charles Smith III u lexuan me detaje dhe rastet ku sipas tyre ish liderët e UÇK-së morën pjesë, duke treguar me detaje dhe zhdukjen e Behajdin Allaqit.

Sipas gjykatës "Behajdin Allaqi kishte pasur një mosmarrëveshje serioze me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën, të cilët e akuzuan se kishte sjellë një spiun të pretenduar të Serbisë, Shaban Shalën, në radhët e lëvizjes politike të cilës i takonin, me çka i kishte vënë në rrezik të madh anëtarët e lëvizjes".

Më tej në vendimin e plotë gjykata theksoi se: "Kjo rezultoi në marrjen prej z. Thaçi të rolit që i ishte premtuar Behajdin Allaqit. Trupi Gjykues gjithashtu ka konstatuar se para zhdukjes së tij, Behajdin Allaqi kishte qenë nën vëzhgimin e shërbimit të zbulimit të UÇK-së. Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli kishin kërkuar të informoheshin për praninë e tij në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Më 11 qershor 1998, ose rreth kësaj date, Behajdin Allaqi u nis prej shtëpisë së vet dhe shkoi në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Pak më pas, mbërritën z. Thaçi dhe Kadri Veseli. Ata e morën Behajdin Allaqin në pranga. Behajdin Allaqi nuk u pa më kurrë dhe Trupi Gjykues është bindur se ai u vra". Smith lexoi më tej se, "për të fshehur përgjegjësinë, personat në fjalë ndërmorën masa të ndryshme. Më 1 nëntor 1998, u publikua Komunikata 61 nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ku thuhej se Behajdin Allaqi kishte rënë dëshmor në betejë. Kjo ishte mbulesë që kishte për qëllim të fshehte të vërtetën për atë që i kishte ndodhur Behajdin Allaqi. Po kështu, pas luftës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Azem Sylja u përpoqën të qetësonin familjen e Behajdin Allaqit me rryshfet dhe premtime në mënyrë që të hiqte dorë nga kërkitë e drejtësisë dhe të vërtetës. Është meritë e jashtëzakonshme e familjes që u rezistoi këtyre ofertave".

Pjesë nga vendimi

Z. Hashim Thaçi mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e krimeve në mënyra të ndryshme që përfshinin si vijon.
Përmasë publikimit të komunikatave dhe deklaratave politike dhe përdorimit të "luftës speciale" z. Thaçi

TË FUNDIT

Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/
Kryegjykatësi Smith tregon me
detaje rastin e zhdukjes së
Behajdin Allaqit

SEPTEMBER 16, 2026

Dokumenti/ Publikohet
aktgjykimi i plotë për ish-
krerët e UÇK-së

SEPTEMBER 16, 2026

Qeveria tërhiqet sërish, rikthen
Bordin e Transparencës pas
rritjes së naftës

SEPTEMBER 16, 2026

Dënimi i ish-krerëve të UÇK,
turma nga sheshet e
Prishtinës nis drejt EULEX-it

SEPTEMBER 16, 2026

"Jo në emrin tim"/ Policia
holandeze arreston disa
mbështetës

SEPTEMBER 16, 2026

Dënimet e Hagës/ Çfarë ndodh
tani me ish-krerët e UÇK-së?

SEPTEMBER 16, 2026

Specialja dënon për krimet
lufte ish-krerët e UÇK-së,
Prishtina shpërthen në revoltë:
Jo fajtor në emër të popullit

SEPTEMBER 16, 2026

"Vendimi i sotëm, i
papranueshëm", Haradinaj: Do
t'i mundim armiqtë të bashkuar

SEPTEMBER 16, 2026

Vëllai i Hashim Thaçit: Presim
Apelin, jemi të bindur në
pafajësi

SEPTEMBER 16, 2026

Reagon vajza e Jakup
Krasniqit pas shqiptimit të
dënimt: Sot ndodhi padrejtësia
më e madhe e këtij shekulli

SEPTEMBER 16, 2026

...shprehur tolerancë dhe inkurajim për kryerjen e krimeve kundër kundërshtarëve.

Z. Thaçi gjithashtu mori pjesë personalisht në krime, përfshirë në arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të 13 parlamentarëve në Qirez dhe Baicë, në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e paligjshme të Behajdin Allaqi, dhe kishte dijeni për arrestimin dhe ndalimin e disa personave të tjerë.

Në lidhje me Behajdin Allaqin, Trupi Gjykses konstatoi se në vitin 1993, Behajdin Allaqi kishte pasur një mosmarrëveshje serioze me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën, të cilët e akuzuan se kishte sjellë një spiun të pretenduar të Serbisë, Shaban Shalën, në radhët e lëvizjes politike të cilës i takonin, me çka i kishte vënë në rrezik të madh anëtarët e lëvizjes.

Kjo rezultoi në marrjen prej z. Thaçi të rolit që i ishte premtuar Behajdin Allaqi. Trupi Gjykses gjithashtu ka konstatuar se para zhdukjes së tij, Behajdin Allaqi kishte qenë nën vëzhgimin e shërbimit të zbulimit të UÇK-së. Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli kishin kërkuar të informoheshin për praninë e tij në shtabin e UÇK-së në Drenoc.

Më 11 qershor 1998, ose rreth kësaj date, Behajdin Allaqi u nis prej shtëpisë së vet dhe shkoi në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Pak më pas, më 11 qershor 1998, z. Thaçi dhe Kadri Veseli. Ata e morën Behajdin Allaqin në pranga. Behajdin Allaqi nuk u pa më kurrë dhe Trupi Gjykses është bindur se ai u vra.

Për të fshehur përgjegjësinë, personat në fjalë ndërmorën masa të ndryshme. Më 1 nëntor 1998, u publikua Komunikata 61 nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ku thuhej se Behajdin Allaqi kishte rënë dëshmor në betejë. Kjo ishte mbulesë që kishte për qëllim të fshihte të vërtetën për atë që i kishte ndodhur Behajdin Allaqi. Po kështu, pas luftës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Azem Sylja u përpoqën të qetësonin familjen e Behajdin Allaqi me ryshfet dhe premtime në mënyrë që të hiqte dorë nga kërkimi i drejtësisë dhe i së vërtetës. Është meritë e jashtëzakonshme e familjes që u rezistoi këtyre ofertave.

Tags: Behajdin Allaqi uck

Previous Post

Dokumenti/ Publikohet aktgjyrimi i plotë për ish-krerët e UÇK-së



Lajm Lajm

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën
qatë punës në Belsh nuk kishte

01



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë,
arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-
vjeçarin

0 SHARES



Qeveria premton rritje pensionesh në prag të
zgjedhjeve vendore

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.